VENDIM
Nr.488, datë 14.7.2006

PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 16 të ligjit nr.8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet për botimet e Qendrës së Publikimeve Zyrtare përfshijnë koston e prodhimit dhe koston e shpërndarjes nga ana e postës.
2. Qendra e Publikimeve Zyrtare realizon edhe shpërndarjen e normave juridike, në mënyrë elektronike, me internet dhe CD-ROM.
3. Tarifat e përdorimit të shërbimeve të përparuara në internet dhe të produkteve dixhitale caktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.
4. Qendra e Publikimeve Zyrtare përdor shërbimin bazë të "Posta Shqiptare" sh.a. për shpërndarjen e Fletores Zyrtare.
5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha